

Pranuar me dt. 25.6.2024			
Nj. orig.	Numër	Nr. ekzempl.	Vlera
01	2/33		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E KOSOVËS



Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor



Nr. 368 prot. Tiranë, më 24.06.2024

Nr. ____ prot. Prishtinë, më __. __. 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Dhe

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

Sot, me datë 24/06 2024 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG), institucion publik qendror, me adresë: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr. 3, Kati i dytë, Tiranë, i krijuar me Ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", misioni i të cilit është krijimi i infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, sipas standardeve evropiane të Direktivës 2007/EC "INSPIRE". ASIG përfaqësohet ligjërisht nga **Drejtori i Përgjithshëm Znj. Vilma Tomço**;

(në vazhdim ASIG)

dhe

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” (UP), institucion publik autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike, me adresë: Rruga “George Bush”, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar ligjërisht nga **Rektori, Prof. Dr. Qerim Qerimi**;

(në vazhdim UP)

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “**Pala**” ose bashkërisht si “**Palët**”.

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve, për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, të fushës së gjeoinformacionit, përmes realizimit të praktikave mësimore dhe zhvillimit të *internship*-ve sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshje.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjeje*, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

- 2.1. Shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor, si dhe burimeve njerëzore me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe përgatitjes praktike të studenteve sipas kërkesave të tregut të punës.
- 2.2. Programe për praktika mësimore dhe *internship* të studentëve të Fakultetit të Shkencave Matematikë-Natyrë (FSHMN).
- 2.3. Pranimi i studentëve praktikantë që plotësojnë kërkesat dhe mundësitë e krijuara nga ASIG.
- 2.4. Pjesëmarrje e ndërsjellët në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët në fushën e gjeoinformacionit.
- 2.5. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta sidomos i trajnimeve në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 3 Angazhimet dhe të drejtat e ASIG:

- 3.1. ASIG merr përsipër të mirëpresë një numër të kufizuar studentësh që do të bëhen pjesë e programeve të praktikave mësimore apo *internship*-eve të përcaktuara nga palët.

- 3.2. ASIG do të asistojë dhe trajnojë studentët e pranuar për praktikë mësimore në çdo proces të programeve të praktikës mësimore që do të zhvillohen në mjediset e tij.
- 3.3. ASIG angazhohet t'i sigurojë palës, kur është e nevojshme (ose kërkohet), vlerësime në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e praktikave të studentëve.
- 3.4. ASIG ka të drejtë të vendosë për numrin e studentëve që mund të kryejnë praktikën në mjediset e tij.
- 3.5. ASIG ka të drejtë të vendosë për kohën dhe për periudhën e përshtatshme të realizimit të programeve të praktikave profesionale në mjediset e tij.
- 3.6. ASIG ka të drejtë të ndërpresë praktikën për studentë të veçantë, ose praktikën si proces në tërësi, në rast se evidenton se studentët nuk respektojnë kushtet e rena dakord paraprakisht mes palëve, ose kur veprimet apo mosveprimet e studentëve mund të dëmtojnë ecurinë normale të punës.

Neni 4

Angazhimet dhe të drejtat e UP-së

- 4.1. UP angazhohet të identifikojë nevojat për projekte konkrete bashkëpunimi mes palëve, në fushën e gjeoinformacionit.
- 4.2. UP angazhohet që do t'i vërë në dispozicion ASIG rezultatet e punës kërkimore shkencore të cilat vijnë si rezultat i këtij bashkëpunimi.
- 4.3. UP ka të drejtë të përzgjedhë studentët potencialë që do të kryejnë programin e praktikës mësimore si dhe ata që do zhvillojnë punën e tyre kërkimore-shkencore, pranë ASIG.
- 4.4. UP, me nënshkrimin e kësaj marrëveshje angazhohet që të bëjë të njohur programin e praktikave mësimore dhe të pranojë ASIG, si një nga partnerët e tij në fushën e gjeoinformacionit.
- 4.5. UP angazhohet që kur është e nevojshme të asistojë studentët, në mjediset e ASIG, para fillimit të programit të praktikës mësimore, si dhe jetë pjesë e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të tyre.

Neni 5


Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 4.1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet nga palët pa afat dhe i shtrin efektet nga momenti i nënshkrimit të saj.
- 4.2. Secila palë mund të zgjidh marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

- 5.1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt do të aplikohen përcaktimet e legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile.

Neni 7
Njoftimet mes palëve

- 6.1. Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar, me postë elektronike ose me faks. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për ASIG:

Person Kontakti: Klaudio Çollaku, Drejtor i Drejtorisë së GIS-it Kombëtar & Gjeoportalit

E-mail: Klaudio.Collaku@asig.gov.al

Mobile: ...

Për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", FSHMN

Person kontakti: Prof. Asoc. Ferim Gashi, Prodekani për cilësi dhe shkencë

E-mail: ferim.gashi@uni-pr.edu

Mobile: +383 (0) 44 114 674

Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve.

Neni 8
Dispozita të përgjithshme

- 7.1. Ndryshimet ose shtesat e pjesëshme që do të bëhen kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.
- 7.2. Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PALËT

**AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOPHAPSINOR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM**


Znj. Vilma Tomço



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
REKTORI**


Prof. Dr. Ferim Qerimi

